



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRI
OPSTINA VUCITRN

PROCESVERBAL

**nga mbledhja e –V-të e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më
14 qershor 2018 në sallën e kuvendit të komunës, e cila filloi në ora 14:10.**

Në mbledhje ishin të pranishëm: Nasuf Aliu (kryesues), Fjolla Ujkani, Ymer Haradinaj, Rrezarta Krasniqi, Shkëlzen Feka, Melihate Basholli-Latifi, Nezir Klinaku dhe Lutfi Bilalli (anëtarë të KPF-së).

Mungoi: Shpëtim Zhegrova.

Gjithashtu në këtë mbledhje morën pjesë edhe: Xhafer Tahiri (kryetar i komunës), drejtorët e drejtorive (Lutfi Gërguri, Sylejman Mehulli, Mehmet Selaci, Berat Asllani, Berat Sadiku), Albanëz Tahiraj, zyrtar i lartë në zyrën ligjore, Haki Maloku, nga sekretaria e kuvendit, Bujar Klinaku.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit dhe i KPF-së, i cili konstatoi se ekzistonte shumica e mjaftueshme për punë.

Ai theksoi se kanë ardhur disa propozime që të futen në rend të ditës:

- a) Shqyrtimi i Propozim-vendimit për miratim të nismës për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të komunës;
- b) Shqyrtimi i Propozim-vendimit për emërtimin e sheshit “Ahmet Krasniqi” në Vushtri;
- c) Shqyrtimi i Propozim-vendimit për përkrahjen financiare për botimin e librit “Trashëgimia arkeologjike e Komunës së Vushtrrisë”;
- d) Shqyrtimi i Propozim-vendimit për themelimin-funksionalizimin e Qendrës për qëndrim ditor për fëmijë me nevojë të veçanta në fshatin Nedakoc;
- e) Shqyrtimi i Draft-kornizës afatmesme buxhetore për vitet 2019-2021;
- f) Shqyrtimi i Draft-planit të veprimit për transparencë në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2018;
- g) Shqyrtimi i Informatës të Drejtorisë për Administratë;
- h) Shqyrtimi i Informatës për shfrytëzimin e pasurisë së komunës.

Rrezarta Krasniqi, anëtare e KPF-së – lidhur me informatën nga Drejtoria për Administratë tha se si informatë ka ardhur me vonesë, pasi që ka qenë e planifikuar me Plan të punës së kuvendit. Prandaj, ajo kërkoi që materialet që janë të planifikuara të vijnë me kohë dhe të futen në rend të ditës, e jo të vijnë në këtë mënyrë të përsheptuar.

Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit dhe KPF-së – theksoi se rast të ngjashëm e kemi edhe informatën nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, e cila ka qenë e planifikuar në Planin e punës së kuvendit dhe ka ardhur me vonesë. Ai i njoftoi të pranishmit se ka biseduar me

kryetarin e komunës dhe drejtorët e drejtorive lidhur me këtë çështje, ku temë diskutimi ishte vonesa e materialeve për procedim në mbledhje të KPF-së dhe kuvend. Prandaj, u kërkua që të bëhet përpjekje që në të ardhmen mos të ketë vonesa të materialeve dhe të procedohet me kohë nga ana e drejtorive.

Mehmet Selaci, drejtor i Drejtorisë për Administratë – theksoi se kjo është një praktikë e re nga ana e drejtorisë sonë, pasi që më parë asnjëherë nuk ka bërë informatë të veçantë Drejtoria për Administratë për kuvend, përveç kur është dërguar së bashku me raportin e kryetarit. Sa i përket vonesës së procedimit të kësaj informate, Selaci theksoi se ka qenë në pushim dhe kjo është arsyeja.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa mbajtur më 18.05.2018;
2. Shqyrtimi i kalendarit kohor për mbajtje të takimeve publike me qytetarë;
3. Shqyrtimi i Informatës lidhur me inspektimin e bizneseve në Komunën e Vushtrrisë;
4. Të ndryshme.
 - a) Shqyrtimi i Propozim-vendimit për miratim të nismës për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të komunës;
 - b) Shqyrtimi i Propozim-vendimit për emërtimin e sheshit “Ahmet Krasniqi” në Vushtri;
 - c) Shqyrtimi i Propozim-vendimit për përkrahjen financiare për botimin e librit “Trashëgimia arkeologjike e Komunës së Vushtrrisë”;
 - d) Shqyrtimi i Propozim-vendimit për themelim-funksionalizimin e Qendrës për qëndrim ditor për fëmijë me nevoja të veçanta në fshatin Nedakoc;
 - e) Shqyrtimi i Draft-kornizës afatmesme buxhetore për vitet 2019-2021;
 - f) Shqyrtimi i Draft-planit të veprimit për transparencë në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2018;
 - g) Shqyrtimi i Informatës të Drejtorisë për Administratë;
 - h) Shqyrtimi i Informatës për shfrytëzimin e pasurisë së komunës.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa mbajtur më 18.05.2018.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi procesverbalin nga mbledhja e kaluar.

2. Shqyrtimi i kalendarit kohor për mbajtje të takimeve publike me qytetarë.

Fjolla Ujkani, anëtare e KPF-së – deklaroi se më datë 29 qershor 2018 është planifikuar të marrë pjesë në Stroc dhe Druar. Ajo kërkoi që të zëvendësohet me dikë tjetër, pasi që me këtë datë nuk ka mundësi të marrë pjesë për shkak të angazhimeve private.

Rrezarta Krasniqi, anëtare e KPF-së – tha se më datë 29 qershor 2018 është planifikuar të marrë pjesë në Novolan dhe Druar. Ajo kërkoi që të zëvendësohet me dikë tjetër, pasi që me këtë datë është jashtë Kosovës dhe nuk ka mundësi të marrë pjesë.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – tha se në këtë draft-kalendar nuk i pashë emrat e përfaqësuesve nga PDK-ja dhe AAK-ja. Ai pyeti se a janë tërhequr nga pjesëmarrja në këto takime, apo kanë dashur që në këtë mbledhje t'i japin propozimet e tyre?

Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit dhe KPF-së – theksoi se në këtë mbledhje kanë kërkuar që t'i japin propozimet e tyre për pjesëmarrje në takime.

Lutfi Bilalli, anëtar i KPF-së – deklaroi se nuk më lë përshtypje a merr pjesë apo jo përfaqësuesi i AAK-së në takimet për dëgjimet buxhetore. Megjithatë, AAK-ja do të merr pjesë në këto takime.

Xhafer Tahiri, Kryetar i komunës – theksoi se është obligim ligjor mbajtja e takimeve publike me qytetarë lidhur me draft-buxhetin e komunës. Prandaj, anëtarët e KPF-së dhe drejtorët e drejtorive duhet të marrin pjesë në këto dëgjime buxhetore.

Shkëlzen Feka, anëtar i KPF-së – tha se anëtari i KPF-së e ka rolin kryesor në këto takime, pra e udhëheq takimin për dëgjime buxhetore. Prandaj, ne si anëtarë të KPF-së duhet të koordinohemi për pjesëmarrje në këto takime, duke shtuar se as unë më datë 29 qershor 2018 nuk do të mund të marr pjesë, kurse ditëve të vikendit do të jem i pranishëm në këto takime.

Melihate Basholli Latifi, anëtare e KPF-së – pyeti se pse nuk është e përfshirë PDK-ja në këto takime?

Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit dhe KPF-së – tha se edhe më herët e sqarova se ky është vetëm një draft, prandaj ka mbetur që në këtë mbledhje të bëhet versioni final i këtij kalendar.

Melihate Basholli Latifi, anëtare e KPF-së – ajo kërkoi që të ketë hapësirë për pjesëmarrje në çdo takim për përfaqësuesin nga PDK-ja dhe shtoi se në disa takime do të marrë pjesë unë, kurse në disa takime do të merr pjesë edhe Shpëtimi.

Shkëlzen Feka, anëtar i KPF-së – tha se anëtari i KPF-së ka të drejtë të marrë pjesë në çdo takim, kurse për ta udhëhequr takimin duhet të koordinohemi së bashku që ta caktojmë nga një kryesues në këto takime.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – kërkoi që përfaqësuesi nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa të merr pjesë në çdo takim për shkak se duhet të jap informata rreth buxhetit.

Komiteti për Politikë dhe Financa i propozoi emrat për pjesëmarrje në takimet publike me qytetarë lidhur me dëgjimet buxhetore dhe njëzëri votoi kalendarin kohor.

3. Shqyrtimi i Informatës lidhur me inspektimin e bizneseve në Komunën e Vushtrrisë.

Xhafer Tahiri, Kryetar i komunës – theksoi se kam kërkuar nga inspektimet që tash e tutje të ketë procesverbal për çdo biznes që e viziton, si dhe të ketë një data-bazë të bizneseve që janë

inspektuar në mënyrë që mos të ketë dallime tek bizneset, e jo disa biznese të vizitohen p.sh. 5 herë e disa biznese tjera mos të vizitohen asnjëherë gjatë vitit. Inspektori do ta ketë këtë listë të përditësuar dhe të azhurnuar, në mënyrë që Drejtoria për Inspektime të veprojë drejtë dhe barabartë ndaj bizneseve.

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së – tha se Drejtoria për Inspektime ka bërë një punë të mirë. Ai tha se kemi disa ankesa të qytetarëve lidhur me reklamimin e produkteve jashtë objektit, pra vendosja e produkteve në trotuare. Ai kërkoi që në kuadër të legjislacionit në fuqi, t’iu kërkohej bizneseve që malli të vendoset brenda objektit e mos të vendoset jashtë, në mënyrë që t’iu lejohej hapësirë qytetarëve të lëvizin lirshëm. Kjo dukuri është e pranishme tek të gjitha bizneset, mirëpo më e evidente është tek ish “Stacioni i vjetër i autobusëve”.

Shkëlzen Feka, anëtar i KPF-së – deklaroi se është një informatë gjithpërfshirëse dhe e përgatitur mirë. Feka e përkrahu idenë lidhur me krijimin e një data-baze për inspektimin e bizneseve.

Melihate Basholli Latifi, anëtare e KPF-së – kërkoi që të vazhdojë inspektimi i kiosqeve dhe dyqaneve në afërsi të shkollës. Ajo tha se është e brengosur për artikujt që shiten si: cigaret me copë dhe pijet energjike.

Xhafer Tahiri, Kryetar i komunës – tha se e ndaj të njëjtën brengë me Melihatën. Prandaj, kuvendi i komunës duhet të marrë një vendim dhe të ndalohej shitja e artikujve të caktuar (p.sh. duhan, alkool, pije energjike) në një perimetër të caktuar. Ai kërkoi nga Zyra ligjore që të fillojë hartimin e një draft-rregulloreje për këtë çështje dhe unë jam i gatshëm që t’ia paraqes kuvendit të komunës këtë draft-rregullore. Nëse është e kundërligjshme na e kthen MAPL.

Berat Asllani, drejtor i Drejtorisë për Inspektime – tha se bizneset afër shkollave si në qytet, po ashtu edhe në fshatra janë inspektuar disa herë lidhur me shitjen e cigareve me copë, sepse kemi pasur ankesa nga drejtorët e shkollave për këtë çështje.

Lutfi Bilalli, anëtar i KPF-së – deklaroi se pajtohet që kuvendi i komunës të marrë vendim për ndalimin e shitjes së disa produkteve në afërsi të shkollave.

Albanez Tahiraj, zyrtar i lartë në Zyrën ligjore – propozoi që të themelohet një komision për hartimin e draft-rregullores.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri e procedoi për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës këtë pikë të rendit të ditës.

4. a) Shqyrtimi i Propozim-vendimit për miratim të nismës për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të komunës.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – tha se kam dashur që të ndërmarrë iniciativë për mbledhjen e nënshkrimeve për ndryshimin dhe plotësimin e statutit, jo për ta rritur numrin e drejtorive, por për ta harmonizuar statutin me legjislacionin në fuqi. E kemi pasur një rast në kuvend kur anëtari i kuvendit Shkëlzen Feka ka propozuar futjen e një pike në rend të ditës edhe pas miratimit të tij. Prandaj, kjo është e keqja, kur “arroganca e numrave” nuk sheh drejtësi. Prandaj, qëllimi bazik i

ndryshimit dhe plotësimit të statutit është harmonizimi me legjislacionin në fuqi dhe eliminimi i kolizionit në mes LVL-së dhe statutit. Po ashtu, emërtimet e vendbanimeve nuk janë të njëjta me zonat kadastrale, ku në kohën sa kam qenë drejtor në Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë kam bërë kërkesë në Agjencionin Kadastral të Kosovës që të harmonizohen zonat kadastrale me emërtim të vendbanimeve, por ajo deri më tani nuk ka ndodhur. Ai tha se mirë është që të ndahet Drejtoria e Shëndetësisë nga Përkujdesja Sociale, Drejtoria për Ekonomi nga Drejtoria për Bujqësi, por po e shoh të paarsyeshme krijimin e Drejtorisë për Projekte. Ndoshta më mirë është që Drejtoria për Urbanizëm të ndahet dhe të bëhet një Drejtori për Rrugët. Prandaj, unë konsideroj se duhet të ketë zvogëlim të drejtorive e jo të rritet numri i tyre.

Shkëlzen Feka, anëtar i KPF-së – theksoi se e përkrah si ide nismën për ndryshimin dhe plotësimin e statutit. Ka shumë pika që komisioni duhet t’i ndryshojë në këtë statut. Unë kisha propozuar që kjo të shkojë në kuvend, të themelohet komisioni dhe komisioni është ai i cili do ta vlerësojë se çka duhet të ndryshohet.

Melihate Basholli Latifi, anëtare e KPF-së – tha se e përkrahu idenë që të ketë zvogëlim të drejtorive. Komisioni mos të bëhet për shkak të balancit politik të koalicionit, por le të jetë një komision profesional.

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së – deklaroi se e përkrahu këtë iniciativë për ndryshimin e statutit. Lidhur me ndarjen e Drejtorisë së Shëndetësisë nga Përkujdesja Sociale dhe Drejtoria për Ekonomi nga Drejtoria për Bujqësi po e shoh të arsyeshme, mirëpo sa i përket Drejtorisë për Projekte, kërkoi informacion shtesë se për çfarë projektesh është fjala. Haradinaj pyeti se nëse drejtoritë në fjalë do të ndahen, drejtoritë ekzistuese a do të shuhet ndonjëra? Sa do të ketë implikime buxhetore ndarja e drejtorive?

Xhafer Tahiri, Kryetar i komunës – theksoi se kjo është vetëm një nismë, prandaj kuvendi i komunës do ta formojë komisionin për ndryshimin dhe plotësimin e statutit dhe komisioni do ta vlerësojë edhe çështjen e drejtorive. Ai theksoi se e kam parë se komuna ka nevojë për Drejtori të Projekteve, kjo për faktin se si komunë kemi të drejtë të aplikojmë edhe në projekte ndërkombëtare, Prandaj, sot nuk e kemi këtë mundësi, sepse nuk kemi staf. Tutje tha se Zyra aktuale e projekteve nuk ka funksionuar dhe nuk funksion, po ashtu nuk e ka të përcaktuar asnjë zyrtar me buxhet. Pastaj tha se duhet ta vlerësojmë se a është më mirë ta kemi një Drejtori për Parqe dhe të Hapësirave Publike që kujdeset për parkingjet e komunës apo duhet ta kemi një kompani publike për këtë qëllim. Ai theksoi se vitin e ardhshëm duhet ta kemi projekt të veçantë “Stacionin e autobusëve”. Shtrohet pyetja se kush do ta hartojë projektin e “Stacionit të autobusëve”. Drejtoria për Shërbime Publike dhe Drejtoria Urbanizëm dhe Mbrojtje Mjedisit nuk i kanë kapacitetet e duhura që ta hartojnë këtë projekt.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja me shtatë (7) vota “për” dhe një (1) votë “kundër” e procedoi për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës këtë pikë të rendit të ditës.

b) Shqyrtimi i Propozim-vendimit për emërtimin e sheshit “Ahmet Krasniqi” në Vushtrri.

Albanez Tahiraj, zyrtar i lartë në Zyrën ligjore – deklaroi se këtij propozim-vendimi duhet t’i rregullohet baza ligjore.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – pyeti se cila pjesë do të jetë sheshi “Ahmet Krasniqi”, sepse në këtë propozim-vendim nuk është e specifikuar, vetëm thuhet para objektit të ri të komunës. Pastaj, cila pjesë do të jetë sheshi “Hasan Prishtina”. Kryetari i komunës është dashur që të ulët dhe të bisedojë me partitë politike e jo të veprohet kështu me politika populiste siç janë bërë praktikë në Kosovë. Prandaj, nuk duhet të veprohet në këtë mënyrë, sepse kam premtuar në fushatë zgjedhore që ta bëjë këtë shesh dhe tash duhet ta bëjë.

Xhafer Tahiri, Kryetar i komunës – sqaroi se hapësira para objektit të komunës është e paraparë që të jetë parking, ku pothuajse në të gjitha komunat është krijuar kjo praktikë jo e mirë që të ketë parking para objektit. Ai tha pse mos ta bëjmë si praktikë të parë në Kosovë, që para objektit të komunës të jetë një hapësirë publike (shesh), ku në krejt botën, hapësirat para objekteve publike janë shesh. Sipas tij, nëse vendos kuvendi i komunës, hapësira para objektit të ri të komunës do ta ketë emërtimin sheshi “Ahmet Krasniqi”. Pengesat në atë hapësirë do të largohen dhe nuk do të lejohet hyrja e automjeteve, pastaj do të vendosen ulëse për qytetarët dhe do të bëhet gjelbërimi i asaj hapësire.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – tha se lidhur me këtë është dashur që të sillet një projekt ideor.

Xhafer Tahiri, Kryetar i komunës – tha se fillimisht duhet ta kemi një vendim të komunës e pastaj bëhet projekti ideor nga Drejtoria për Urbanizëm, që nuk ka nevojë të shkojë në kuvend.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – pyeti se ku do të bëhet parkimi i automjeteve?

Xhafer Tahiri, Kryetar i komunës – nuk është e thënë që patjetër duhet të vijnë qytetarët me veturë në komunë. Po ashtu, edhe stafi i komunës nuk është e thënë të vijnë me vetura në komunë, por le të vijnë në këmbë. Stafi i komunës le ta bëjë zgjidhjen vetë se ku do ta parkojë veturën, ndërkaq sa i përket veturave të komunës do ta gjejnë një zgjidhje se ku do të parkohen.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – tha se nuk duhet të veproni në këtë mënyrë dhe vetëm pse i keni numrat t’i votoni çështjet. “arroganca e numrave” nuk sheh drejtësi, ku njëjtë keni vepruar edhe me mirënjohjet për “Ditën e Çlirimit”, ku për këtë datë nuk iu keni ndarë mirënjohje asnjë pjesëtari të UÇK-së. Një propozim e bëra për një qytetar që ka marrë pjesë në tri luftëra, “arroganca e numrave” të LDK-së, VV-së i votuat propozimet e juaja, tha ai. Prandaj, nuk kam pritur nga LDK-ja që ta votojë këtë propozim, por nga VV-ja e kam pritur një gjë të tillë.

Shkëlzen Feka, anëtar i KPF-së – theksoi se ajo që kërkoi kolegu Neziri, për kuvend mund të plotësohet. Feka tha se shprehja “arroganca e numrave” po më pengon, sepse merren për bazë edhe propozimet e opozitës dhe sikur të kishte “arrogancë të numrave” do të veprohej ndryshe dhe nuk do të merreshin për bazë asnjë propozim i opozitës.

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së – u shpreh se edhe mua po më pengon termi “arroganca e numrave”, mirëpo në secilin kuvend komunal, por edhe në Kuvendin e Kosovës ekziston një marrëveshje politike e cila duhet të vlerësohet.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja me shtatë (7) vota “për” dhe një (1) votë “abstenim” (Nezir Klinaku), e procedoi për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës këtë pikë të rendit të ditës.

- c) Shqyrtimi i Propozim-vendimit për përkrahjen financiare për botimin e librit “Trashëgimia arkeologjike e Komunës së Vushtrrisë”.

Xhafer Tahiri, Kryetar i komunës – theksoi se është botimi më i rëndësishëm për trashëgiminë kulturore të Vushtrrisë, ku do të shënjohej të gjitha hapësirat arkeologjike të komunës sonë. Ky libër do të botohet në gjuhën shqipe dhe angleze.

Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit dhe KPF-së – deklaroi se arsyetimi duhet ta ketë autorin në fund që ta dimë a po vjen propozimi nga kryetari apo nga drejtoria përkatëse.

Albanez Tahiraj, zyrtar i lartë në Zyrën ligjore – deklaroi se këtij propozim-vendimi duhet t’i rregullohet baza ligjore, si dhe tek paragrafi 1, historiku se si ka shkuar lënda nuk shkruhet në akt normativ, por në arsyetim.

Melihate Basholli Latifi, anëtare e KPF-së – tha se drejtoria duhet ta ketë një plan të botimeve, sepse siç është e cekur në këtë propozim-vendim shuma është e lartë. Prandaj, drejtoria duhet ta sjellë propozim-vendimin me një shumë tjetër, sepse nuk iu lë hapësirë për t’i përkrahur kërkesat tjera. Konsideroj që drejtoria duhet t’iu jep hapësirë më shumë studentëve-botues dhe nxënësve-botues të shkollave të mesme dhe fillore, sepse ata kanë nevojë më shumë për përkrahje.

Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit dhe KPF-së – tha se pesha e këtij dokumenti është e madhe dhe nuk mund të krahasohet me botimet e studentëve dhe nxënësve.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja me gjashtë (6) vota “për” dhe një (1) votë “abstenim” (Nezir Klinaku) rekomandoi që Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport së bashku me Drejtorinë për Financa t’i analizojnë mundësitë buxhetore se a ka mjete financiare që të përkrahet botimi i këtij libri, apo të ndryshohet propozim-vendimi dhe të caktohet një shumë më e vogël financiare. Me këto plotësime të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

- d) Shqyrtimi i Propozim-vendimit për themelim-funksionalizimin e Qendrës për qëndrim ditor për fëmijë me nevoja të veçanta në fshatin Nedakoc.

Albanez Tahiraj, zyrtar i lartë në Zyrën ligjore – tha se këtij propozim-vendimi duhet t’i rregullohet baza ligjore.

Melihate Basholli Latifi, anëtare e KPF-së – ky propozim-vendim ka gabime teknike dhe drejtshkrimore.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që pas përmirësimit të procedohet për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës këtë pikë të rendit të ditës.

- e) Shqyrtimi i Draft-kornizës afatmesme buxhetore për vitet 2019-2021.

Lutfi Gërguri, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa – i informoi të pranishmit se drejtoria ka bërë kërkesë në Ministrinë e Financave për rritjen e subvencioneve dhe komunalive.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që pas përmirësimit të procedohet për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës këtë pikë të rendit të ditës.

f) Shqyrtimi i Draft-planit të veprimit për transparencë në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2018.

Blerim Zhabari, udhëheqës i Zyrës për komunikim me publikun – tha se sipas udhëzimit Administrativ, është obligim që të bëhet çdo vit ky plan. Ky udhëzim administrativ është duke u ndryshuar dhe ndoshta në të ardhmen nuk do hartohet çdo vit ky dokument. Ai kërkoi që ky dokument mos të shkojë në diskutim publik nëse nuk shkelen procedurat, pasi që është dokumenti i njëjtë që ka qenë vitin e kaluar dhe është konsultuar publiku për këtë.

Albanez Tahiraj, zyrtar i lartë në Zyrën ligjore – deklaroi se nuk e lejon ligji që një dokument nëse është në shqyrtim të parë mos të shkojë në diskutim publik.

Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit dhe KPF-së – tha se komuna ka një plan të veprimit dhe se nuk është emergjente kjo në mënyrë që të bëjmë shkelje ligjore dhe mos ta dërgojmë në diskutim publik. Prandaj, ky dokument le të shkojë në diskutim publik dhe t’iu nënshtrohet procedurave ligjore.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – theksoi se jemi mësuar ta përdorim fjalën transparencë, a në anën tjetër vet kryetari i komunës nuk është transparent, ku i publikon shpenzimet e tij për një muaj p.sh. 13 euro, kjo është absurde. Prandaj, më mirë është të merremi me vendimet e kryetarit të komunës që nuk është transparent dhe nuk i publikon vendimet e tij në web faqe, gjë që është e rregulluar kjo çështje sipas legjislacionit në fuqi.

Blerim Zhabari, udhëheqës i Zyrës për komunikim me publikun – deklaroi se është e vërtetë që sipas legjislacionit në fuqi vendimet e kryetarit duhet të publikohen. Mirëpo, në web faqen e re është një problem dhe duhet të shkohet tek profili i kryetarit, e në brendi gjendet linku për vendimet, ku janë të publikuara komplet vendimet e kryetarit.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës këtë pikë të rendit të ditës.

g) Shqyrtimi i Informatës të Drejtorisë për Administratë.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës këtë pikë të rendit të ditës.

h) Shqyrtimi i Informatës për shfrytëzimin e pasurisë së komunës.

Berat Sadiku, drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje Mjedisit – deklaroi se vonesa për dërgimin e mëhershëm të kësaj informate ka ndodhur pasi që në Planin e punës së kuvendit ka

figuruar që kryetari i komunës ta përgatis# këtë informatë. Mirëpo, ne vonë jemi informuar se ne si drejtori duhet ta përgatisim.

Rrezarta Krasniqi, anëtare e KPF-së – lidhur me vonesat e materialeve, ajo deklaroi se unë si anëtare nuk do të votojë nëse nuk na vijnë me kohë materialet.

Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit dhe KPF-së – tha se në takim me kryetarin, nënkryetarin dhe drejtorët e drejtorive e kemi biseduar çështjen e vonesës së materialit. Po shpresojmë se nuk do të ndodhin në të ardhmen këto vonesa.

Mbledhja përfundoi në orën **15:35**.

Bujar Klinaku

Bujar Klinaku
Procesmbajtës



Nasuf Aliu
Nasuf Aliu

Kryesues i KK-së dhe i KPF- së